



Edizioni i parë, 2021

Historia ime NË ERASMUS+



Erasmus+





UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE



Lagjia “Pavarësia”, Rruga “Kosova”, 9400, VLORE, ALBANIA



<https://univlora.edu.al/en/>



Universiteti Ismail Qemali Vlorë



UniVlora2



U.V. Ismail Qemali



Universiteti Ismail Qemali Vlore



INFORMACION

MBI UNIVERSITETIN E VLORËS

Themeluar në vitin 1994, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV) është një institucion i arsimit të lartë publik, i vendosur në qytetin bregdetar të Vlorës, Shqipëri. I akredituar dhe i njohur zyrtarisht nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri, UV numëron 6.100 studentë dhe 12.000 studentë të diplomuar.

UV u ofron studentëve një arsim me cilësi të lartë dhe të përballueshme përmes një kombinimi të larmishëm të studimeve, udhëzimeve profesionale dhe përvojës kulturore dhe sociale. Studentët do të gjejnë në Universitetin e Vlorës një gamë të gjerë të programeve akademike të bazuara në Sistemin e Bolonjës në tre nivele studimi Bachelor, Master, si dhe një program doktoreture në Matematikë përmes katër strukturave kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ku ofrohen studime në fushën e drejtësisë, edukimit dhe mësimdhënies, gjuhës shqipe dhe të huaja, pedagogji e specializuar, histori dhe gjeografi, psikologji, etj.
2. Fakulteti i Ekonomisë ku ofrohen studime në ekonomi, menaxhim biznesi dhe studime të turizmit.
3. Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore ku ofrohen studime në disa fusha të inxhinierisë dhe shkencave natyrore si detari, mekanike, inxhinieri elektrike, biologji, kimike, informatikë, matematikë, fizikë, kërkime në fushën kimike etj
4. Fakulteti i Shëndetit Publik ku ofrohen studime në fushën e infermierisë dhe shëndetit publik.




Erasmus+
Enriching lives, opening minds.



Open your mind, change your life !

SHARE YOUR EXPERIENCE
during the
#ERASMUSDAYS



What are you doing for #ErasmusDays ?



RRETH ERASMUS +

Erasmus+ është një program i Bashkimit Evropian (BE) që mbështet financiarisht një sërë veprimtarish në fushat e Arsimit, Trajnimit, Rinisë dhe Sportit. Erasmus + ngrihet mbi përvojën dhe suksesin e programeve të mëparshme arsimore të BE-së (Tempus, Erasmus Mundus, Alfa, Edulink etj) dhe mbështet shkëmbimet ndërkombëtare të studentëve, stafeve akademike dhe administrative, qarkullimin e praktikave më të mira midis institucioneve të arsimit të lartë dhe forcimin e lidhjeve midis arsimit dhe tregut të punës.

Bashkëpunimi me vendet partnere mbështetet nëpërmjet:

KA1-“Mobiliteti i të nxënit” përfshin shkëmbimin e studentëve, lektorëve dhe stafit administrative nga dhe në Vendet Partnere. Përfaqson rreth 63% të buxhetit total të programit.

a) *Mobiliteti i Krediteve* - Në fushën e mobilitetit të krediteve, Institucionet e Arsimit të Lartë nga Vendet e Programit do të aplikojnë për menaxhimin e projekteve të mobilitetit të studentëve, pedagogëve, dhe stafit administrativ të universiteteve.

b) *Shkëmbimet për mastera të përbashkëta* - Programi mbështet ndërtimin e konsorciumeve që ofrojnë programe Masteri të Përbashkët Evropianë, me kohë të plotë që zgjasin një ose dy vite.

KA2 - “Bashkëpunimi për inovacionin dhe shkëmbimin e praktikave të mira” Përfshin bashkëpunimin për inovacionin dhe shkëmbimin e praktikave të mira midis institucioneve arsimore dhe ndërmarrjeve private e aktorëve të tjerë, rritjen e kapaciteteve në vendet e pa industrializuara (ish projektet Tempus). Përfaqëson rreth 28 % të buxhetit total.

Projektet për ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë mbështesin modernizimin, aksesin dhe ndërkombëtarizimin e universiteteve në Vendet Partnere.

Aktivitetet e Jean Monnet mbështesin dhe promovojnë thellimin e njohurive rreth çështjeve të Integritetit Evropian, mësimdhënies dhe kërkimin mbi historinë, politikën, ekonominë, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe legjisllacionin e Bashkimit Evropian.



Vetëm, ne mund të bëjmë kaq pak,
së bashku mund të bëjmë kaq shumë!

Universiteti i Vlorës


drejt **Erasmus+**

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë promovon dhe inkurajon dimensionin ndërkombëtar të studimeve, mësimit dhe kërkimit shkencor duke e konsideruar këtë si një nga detyrat themelore të universitetit në zhvillimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve, stafit akademik dhe administrativ.

UV ka projekte të përbashkëta dhe programe shkëmbimi me disa nga universitetet më të mira në botë dhe vazhdimisht përpiqet të zgjerojë më tej bashkëpunime të tilla. Në kuadër të Erasmus+ KA107 UV aktualisht numëron 82 marrëveshje ndërinstitucionale me Universitete nga 21 vende të Programit. Deri më tani janë realizuar në total 137 mobilitete për studentë dhe 225 mobilitete për staf akademik dhe administrativ.

UV ka një përvojë të gjatë në menaxhimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga programet e BE, ku është identifikuar si një partner i drejtë dhe i besueshëm. Aktualisht, janë 17 projekte në implementim nga UV, nga ku 9 projekte janë të financuara nga programi Erasmus + CBHE (Ndërtimi i Kapaciteteve në Arsimin e Lartë); dhe 1 nga programi Moduli Erasmus + Jean Monnet.

ZGJIDH DESTINACIONIN TËND!





| Studentë dalës |

Studenti: Xhino Çala
Institucioni dërgues: Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Programi E+: Shkëmbim Studentor
Institucioni Pritës: Universiteti i Shkencave të Aplikuara Kalisz, Poloni
Periudha: Shkurt - Prill 2020

“Krijë kujtime të bukura, falë Erasmus+”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Unë quhem Xhino Çala dhe këtë vit mbarova studimet master. Fillimisht për programin Erasmus+ jam njohur nëpërmjet një shoku që kishte fituar një bursë Erasmus në Letoni. Në atë kohë sapo kisha filluar studimet master dhe kjo mundësi mu duk brilante për një eksperiencë studentore. Diku nga muaji dhjetor 2019 pashë një njoftim online në faqen e universitetit, i cili jepte bursë praktike e cila përputhej edhe me programin e studimeve që po ndiqja. Menjëherë vendosa që duhej ta provoja dhe ditën tjetër shkova tek Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë për të marrë informacion rreth procesit të aplikimit. Çdo gjë u bë e thjeshtë me mbështetjen e zyrës dhe brenda dy ditësh arrita të përfundoj aplikimin, i cili u dorëzua tek zyra për të bërë përzgjedhjen. Pas rreth një jave njoftohem se e kisha fituar bursën, isha i emocionuar dhe i gëzuar në të njëjtën kohë.

Më pas filluan procedurat me zyrën e universitetit pritës, është një rrjedhë hapash që bëhen ndërmjet dy universiteteve dhe mbështetja ka qenë në çdo moment e pakursyer nga të dyja palët. Nga fundi i janarit çdo gjë ishte gati për nisje. Nisja u bë në fund të shkurtit, e cila korrespondonte edhe me semestrin e fundit të masterit e cila ishte praktika. Isha shumë entuziast për këtë përvojë të re dhe unike në jetën time.

Përvoja ime në Kalisz

Udhëtimi ishte eksperiencë më vete pasi qëndrova edhe një natë në një qytet tjetër turistik të Polonisë para se të mbërrija në konviktin e universitetit. Pasi u mobilizova në dhomën ku do të qëndroja filloi edhe njohja me studentët e tjerë Erasmus, të cilët ishin nga vende të ndryshme të Europës, por edhe nga Turqia, çdo gjë ishte më mirë nga çfarë prisja, duke filluar nga njerëzit e stafit dhe studentët e tjerë e deri tek kushtet e ambientit ku do të qëndroja.

Më pas filloi edhe praktika tek zyra e Teknikëve të IT në universitet, të gjithë u treguan shumë mikpritës edhe të gatshëm të ndihmonin me çdo gjë që do të më nevojitej. Që në javën e parë të mbërritjes bëra dhe udhëtimin e parë në vend me një grup studentësh në një nga vendet më të vizituara në turizmin dimëror, ishte një eksperiencë mbresëlënëse. Qyteti ishte një ndër më të vjetrit e vendit dhe tek- tuk mund të shihje edhe pasojat e Luftës së 2-të Botërore. Ishte një qytet i vogël, por shumë i bukur dhe i zhvilluar me të gjitha kushtet që njerëzit mund të bëjnë një jetesë të kënaqshme.

Por nuk zgjati shumë edhe filloi karantina për shkak të Covid-19 dhe bashkë me të cdo gjë ndaloi. Studimet u transferuan online dhe gjithë ditën rrinim në konvikt, por kushtet ishin dhe kishim se me çfarë të argëtoheshim pasi kishim edhe një sallë kinemaje ku zhvillonim festa edhe shihnim filma, kishim edhe lojra të ndryshme si ping pong etj. Më pas levizëm në një kampus universitar ku ndenjëm vetëm 21 studentë Erasmus rreth 3 muaj.



Ajo do të kthehej në një nga aventurat më të bukura që kisha kaluar ndonjëherë pasi jam edhe tip me shpirtin e aventurës.

Kishim një hapësirë shumë të madhe me fusha futbollit dhe volleyball dhe me parqe natyrore. Ja kalonim shumë bukur dhe u bëmë si një familje me njëri - tjetrin, janë kujtime që do të ngelen gjatë në memorijen time. Praktika mbaroi me sukses online dhe u mbyll me vlerësim maksimal. Për shkak të pandemisë dhe mbylljes së kufijve u desh të qëndroja më tepër kohë dhe të shtyja kthimin në atdhe, komunikimi ishte i vazhdueshëm me zyrat e universiteteve për të gjetur një rrugë kthimi dhe nuk vonoi shumë edhe gjetja e një bilete riatëdhësimi për në Shqipëri.

Universiteti pritës mundësoi edhe transportin në një qytet tjetër nga ku do të bëhej edhe nisja me autobus për në aeroportin në Gjermani, çdo gjë shkoi mirë dhe mbërritja në Shqipëri u bë pa asnjë pengesë.

Ajo që mund të them për eksperiencën Erasmus edhe se nëse do më jepej mundësia përsëri për ta bërë nuk do hezitova asnjë sekondë pasi është gjëja më e bukur që mund t'i ndodh një studenti.





Studenti: Adelina Nika
Institucioni dërgues: Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Programi E+: Shkëmbim Studentor
Institucioni Pritës: Universiteti Jan Kochanowski, Poloni
Periudha: Shkurt 2019 - Korrik 2019

“Jam një njeri më i mirë, falë Erasmus+”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Unë quhem Adelina Nika, këtë vit unë mbylla studimet Bachelor në degën Gjuhë të huaja (ANGLISHT). Që në gjimnaz unë kam dëgjuar nga njerëzit e mi mbi programin e Erasmus dhe që atëherë dëshira ime ka qenë shumë e madhe për të marrë pjesë. Në vit të dytë në klasën tonë erdhi shefja e departamentit ku na informoi mbi erasmusin dhe e cila trajtoi në mënyrë shumë të detajuar procesin e këtij programi. Në çdo moment stafi i zyrës ka qenë i gatshëm për të më ndihmuar me informacionet që më nevojiteshin për të plotësuar procedurat që duheshin ndjekur. Kam aplikuar në program në dhjetor të 2018 dhe në janar 2019 u shpalla fituese. Mund ta them me bindjen më të madhe se aplikimi për Erasmus ka qenë zgjedhja më e mirë që mund të kem bërë gjatë gjithë jetës time. Por, mund të them se përgatitja e dokumentacionit ka qenë një procedurë pak e lodhshme dhe e vështirë, por Zyra e ERASMUS më ka ndihmuar në çdo moment, duke më ndihmuar që të përfshihesha me të gjitha dokumentet e duhura për aplikim, ato që kërkonte institucioni pritës por edhe me Learning Agreement. Por, çdo gjë u përfundua me sukses. Që në momentin që unë kam aplikuar për bursën e erasmusit unë kam qenë optimiste, kam qenë shumë e lumtur dhe shumë e gatshme për këtë eksperiencë të re, nuk kisha frikë fare në lidhje me jetën larg familjes, sepse unë kam jetuar edhe më parë dhe jam përshtatur. Dhe ditët kaluan sa hap e mbyll sytë pa e kuptuar fare dhe momenti që të filloja aventurën time të re kishte ardhur.

Përvojat e mia në Kielce

Menjëherë pasi zbrita nga avioni, e gjeta veten në një ambient shumë të ndryshëm nga ai që ne kemi këtu dhe një mot shumë të ftohtë, por unë paraprakisht e kisha ndjesinë se gjithçka do të shkonte super mirë dhe do të kaloja me të vërtetë shumë bukur. Qyteti ishte shumë i bukur dhe nëse mua do më jepej një mundësi të ikja përsëri nuk do mendoheja fare, por do pranoja me shumë dëshirë. Ajo çfarë më befasoi më shumë ishte konvikti ku ne jetuam. Unë kisha fatin e mirë që ta gjenim pa asnjë lloj vështirësie falë stafit pritës, ishte një konvikt i kompletuar me çdo gjë.





Mund të cilësoj se sigurisht që pjesë e përvijës së këtij shkëmbimi nuk është vetëm shkolla, por edhe koha e lirë. Dhe momente super të bukura, që unë mund të kujtoj janë kur mbledheshim të gjithë në korridorin e konviktit disa duke pirë alkool disa kafe (unë domethënë), luanim lojëra të ndryshme dhe kërcenim jashtë mase shumë dhe kërcimi OROBO ishte kërcim tradite, që ata bënin për çdo student të huaj që vinte, por dhe mësonim kulturat e njëri-tjetrit, ndanim eksperiencat tona.

Jo vetëm njihnim njëri-tjetrin, por njihnim edhe veten tonë më mirë, sepse je i pavarur dhe duhet të menaxhosh kohën në mënyrë më të mirë.

Qyteti i Kielces kishte një ndërthyrje midis kohërave të vjetra dhe asaj të re-së. Kjo eksperiencë më formoi shumë, jo vetëm në aspektin profesional, por u formova gjithashtu dhe si individ më i mirë, e gatshme për t'i bërë ballë problemeve të ndryshme.

Asgjë nuk është e vështirë nëse e dëshiron me të vërtetë diçka. Të gjithë njerëzit kanë frikë, por nëse do të krijosh momente shumë të bukura, atëherë duhet të guxosh. Duhet guxuar për të kuptuar, a i dëshiron vërtetë ato ëndrra e tua? Dhe dua të vë në dukje se ERASMUS me hapi shumë dyert për çdo aspekt të jetës. Unë do flisja pa pushim rreth të mirave që sjell Erasmus, por ju sygjeroj që më mirë aplikoni, fitoni dhe do më kuptoni vetë për të gjitha këto nga eksperiencia që do kaloni.

Do ju thoja vetëm të lini çdo frikë dhe ankth që keni në lidhje me mos arritjen në Erasmus, sepse kjo gjë ndodhet vetëm në mendjen tuaj. Erasmus është një nga gjërat më të bukura që ju mund të bëni. Ju nxis që të aplikoni sa më shumë.

*"Ndërsa isha jashtë,
gjeta guximin që kurrë
nuk e dija se kisha. Zbulova se sa më larg që të largohesha nga shtëpia,
aq më afër arritja të gjeja veten."*





Studenti: Endri Tahiraj
Institucioni dërgues: Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Programi E+: Shkëmbim Studentor
Institucioni Pritës: Universiteti Jan Kochanowski në Kielce, Poloni
Periudha: Shkurt 2020 - Korrik 2020

“Jam një njeri më i mirë, falë Erasmus+”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Mua më quajnë Endri Tahiraj dhe këtë vit mbarova vitin e dytë Bachelor në “Gjuhë Angleze”. Për programin Erasmus+ u informova në fillim të vitit të parë dhe mu duk shumë i mirë për të qenë i vërtetë. Por, më pas mora pjesë në një nga takimet ku nxënësit flisnin për eksperiencat e tyre në vendet ku kishin shkuar nëpërmjet programit Erasmus+. Kështu vendosa ta provoja edhe unë.

Të gjithë ishin të gatshëm të më ndihmonin për ndonjë problem që mund të lindte, stafi ishte gjithnjë i gatshëm, por edhe studentët që kishin qenë më parë, edhe pedagogët gjithashtu.

Pasi aplikova mora përgjigjen që isha fitues dhe në Shkurt të 2020 u nisa për në qytetin ku fitova të drejtën e studimit. Në fillim isha pak në ankth, sepse ishte një vend për të cilin dija thajse asgjë. Por, mikpritja e përfaqësuesve të universitetit pritës e shkriu gjithë atë ankth.

Përvojat e mia në Kielce

Universiteti ishte gjigand, pedagogët të sjellshëm dhe nuk na ndanin nga studentët vendas. Nuk u ndjemë asnjëherë të diskriminuar, as nga pedagogët e as nga nxënësit, përkundrazi të gjithë ishin të gatshëm për të të ndihmuar. Edhe pse nuk pata shumë kohë për të frekuentuar universitetin për shkak të virusit COVID-19, për aq sa zgjati ja kalova shumë mirë.

Për sa i përket konviktit, dhomat ishin të rregullta, të pastra dhe të bollshme, pra gjithçka na nevoitej.

Edhe pse të mbyllur brenda për shkak të virusit COVID-19, stafi i zyrës së Erasmus+, si ata në Shqipëri por edhe ata në vendin pritës shpesh herë na dërgonin informacione mbi mbrojtjen ndaj virusit e shumë gjëra të tjera të kësaj natyre.

Por për veç kësaj na pyesnin shpesh edhe për shëndetin.

Edhe pse këtë vit ishte e vështirë për të kaluar një kohë të bukur, ne ja kaluam shumë mirë. Ja arritëm të vizitonim vende si Krakov, Varshavë dhe Katovicë. Ishin vende shumë të bukura.

Shpesh herë rrinim zgjuar deri vonë, herë bënim muhabet me studentët nga vendet e tjera, herë flisnim për mësimet dhe projektet dhe ndonjëherë luanim lojra të ndryshme.



Kështu ja arritëm ta mundim virusin. Edhe pse virusi u mundua shumë të na ndalonte të kënaqeshim këtë vit me anë të programit Erasmus+ nuk ia doli dot, unë ja kalova shumë bukur, po ashtu edhe miqtë e mi.

Përderisa, ne ja kaluam bukur në “kohë korone” ju mund t’ia kaloni super, prandaj ju sugjeroj të aplikoni.





Studenti: Alboren Selimaj
Institucioni dërgues: Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Programi E+: Shkëmbim Studentor
Institucioni Pritës: Universiteti i Atikës Perëndimore Athinë, Greqi
Periudha: Mars 2020 - Qershor 2020

“Erasmus+ zgjedhja më e mirë, që kam bërë”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Unë quhem Alboren Selimaj, jam student i Inxhinierisë Elektrike në vitin e dytë. Dëshira ime për të studiuar jashtë vendit tim ka qenë e madhe përgjatë viteve të gjimnazit. Kur u informova mbi programin e shkëmbimit studentor Erasmus, kjo dëshirë u kthye në një qëllim mjaft të dobishëm për veten. Pak kohë pas fillimit të vitit të dytë ishin hapur thirrjet për aplikime. Me kontaktoi Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë e universitetit që të aplikoja për semestrin e dytë jashtë vendit. Vendi në të cilin aplikova ishte Greqia. Kaloi pak kohë pas aplikimit dhe fatmirësisht u shpalla fitues.

Zgjedhja më e mirë që kam bërë. Pjesë aplikimit ishte përgatitja e dokumentacionit, por Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë më ka ndihmuar në çdo moment, duke përfshirë dokumentet e duhur për aplikim, ato që kërkonte institucioni pritës por edhe me Learning Agreement. Megjithatë çdo gjë u përfundua me sukses.

Gjatë gjithë kohës isha i gëzuar dhe optimist për këtë eksperiencë të re. Gjithsesi, frika qëndronte sesi unë do të përshtatesha me këtë situatë dhe qytet të ri. Ditët kaluan pa kuptuar dhe momenti që të filloja aventurën time të re kishte ardhur.

Përvojat e mia në Athinë

Me kalimin e kohës po afrohej dita në të cilën kisha prerë biletën për të shkuar në Greqi. Atje shkova me autobus, rruga dhe orari i gjatë i udhëtimit ishte pak i lodhshëm dhe njëkohësisht i këndshëm pasi pashë vende të cilat syri im nuk i kishte parë. Pasi arrita në destinacion po përjetoja një ndjesi se gjithçka do të shkonte mirë dhe do të kaloja bukur. Qyteti ishte fantastik, nëse do më thonin të shkoja sërish atje do të shkoja me shumë dëshirë.

Dalloheshim shumë lehtë nga vendasit atje, por pikërisht kjo e bënte më të vecantë, sepse nxirrnin gjithmonë e më në pah natyrën e tyre mjaft mikëpritëse. Njerëzit ishin shumë të sjellshëm dhe mjaft ndihmues.





Sigurisht që pjesë e përvojës së këtij shkëmbimi nuk është vetëm shkolla, por edhe koha e lirë. Momente shumë të bukura që kujtoj është kur mblidheshim si shoqëri për të folur mbi tema të ndryshme, mësonim kulturat e njëri-tjetrit, ndanim eksperiencat tona. Jo vetëm njihnim njëri-tjetrin, por njihnim edhe veten tonë më mirë, sepse je i pavarur dhe duhet të menaxhosh kohën në mënyrë më efikase.

Qyteti kishte një ndërthyrje si të të vjetrës dhe asaj të re-së. Qyteti i vjetër i Athinës i vendosur në qendër kishte një stil shumë të veçantë prandaj si turistët, vendasit, por edhe ne shkonim shpesh atje. Ajo çfarë më pëlqente ishte se qyteti organizonte shpesh aktivitete të ndryshme për të gjitha shijet dhe preferencat e njerëzve. U njohëm me traditën e tyre, me ushqimin vendas, pijet e tyre, por duke qenë se jetonim në kryeqytet provuam dhe ushqime të kuzhinave ndryshme.

Kjo eksperiencë ka ndikuar në formimin tim. Më ndihmoi të isha një njeri më i mirë, i gatshëm për t'i bërë ballë problemeve të ndryshme.

Asgjë nuk është e vështirë nëse e dëshiron me të vërtetë diçka. Të gjithë njerëzit kanë frikë, por nëse do të krijosh momente të bukura, atëherë duhet të guxosh. Duhet guxuar për të kuptuar a i dëshiron vërtetë ëndrrat e tua, a je ambicioz, dhe po ashtu gjen përgjigje për shumë pyetje të tjera. Dhe nuk ka më mirë se të dalësh nga zona e komfortit falë programit Erasmus, sepse vihesh përballë situatave të ndryshme krejt i vetëm. Do flisja pafund rreth të mirave që sjell ky program, por më mirë aplikoni, fitoni dhe do i kuptoni vetë të gjitha këto nga eksperiencia që do kaloni.

Pasiguria dhe mendimet që nuk mund t'ja dilni janë vetëm një hap pas. Mos lejoni t'ju mundin. Aplikoni, kini besim tek vetja dhe mos u dorëzoni. Ja vlen çdo sekondë e këtij program.

Kurrë mos hezitoni të provoni një eksperiencë të re ashtu sikurse njihjen e të "panjohurës" edhe nëse rezultojnë një gabim atëherë do të jetë një mësim i vlefshëm për ju.

*"Merr një
experiencë
të re falë
Erasmus +"*





Studenti: Prishila Korkaj
Institucioni dërgues: Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Programi E+: Shkëmbim Studentor
Institucioni Pritës: Universiteti i Atikës Perëndimore, Greqi
Periudha: Mars 2020 - Qershor 2020

“Guxoni dhe provoni Erasmus+”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Unë quhem Prishila Korkaj, jam viti II Bachelor në degën Financë. Që në gjimnaz kam dëgjuar mbi programin e shkëmbimit studentor Erasmus dhe dëshira ka qenë e madhe për të marrë pjesë që atëherë. Në vit të parë në universitetin tonë u organizua një takim me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, e cila trajtoi në mënyrë shumë të detajuar procesin e këtij programi.

Gjithashtu, nëpërmjet shoqërisë dhe njohjeve që kisha, u informova plotësisht se çfarë ishte Erasmusi, kriteret që kishte si dhe mënyrën e aplikimit.

Në çdo moment stafi i zyrës ka qenë i gatshëm për të më dhënë informacionet e nevojshme mbi procedurat që duheshin ndjekur, por edhe më jepnin mbështetjen e tyre. Kam aplikuar në program në dhjetor të 2018 dhe në janar 2019 u shpalla fituese. Shteti ku do të kryeja mobilitetin ishte Greqia. Universiteti pritës ndodhej në Athinë.

Një pjesë pak e vështirë ka qenë përgatitja e dokumentacionit, por Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë më ka ndihmuar në çdo moment, duke përfshirë dokumentet e duhur për aplikim, ato që kërkonte institucioni pritës por edhe me Learning Agreement.

Megjithatë çdo gjë u përfundua me sukses.

Në momentin që u shpalla fituese dhe përfundova të gjitha dokumentacionet e nevojshme, ishte momenti të merrja përsiper këtë aventurë.

Ditët kaluan pa u kuptuar dhe erdhi koha e largimit.

Përvojat e mia në Athinë

Frika se si do të përshtatesha në një vend të huaj ishte e madhe. Universiteti jonë ndryshe nga universitetet e tjera nuk kishte një konvikt dhe ne ishim të detyruar të akomodohehim në ambiente private si shtëpi me qera. Ishte pak i vështirë procesi i gjetjes së një ambienti duke qenë se nuk dinim mirë dhe qytetin. Gjithsesi me ndihmën e universitetit prites arritëm të sistemoheshim. Qyteti ishte shumë i bukur dhe kishte një arkitekturë mbresëlënëse.

Fakti që nuk ishim vendas na i bënte më të lehtë qëndrimin, pasi çdokush dëshironte të dinte më shumë ndaj nesh dhe ndaj shtetit që ne përfaqësonim. Universiteti ishte shumë i bukur dhe njerëzit ishin shumë mikëpritës duke na bërë ne të ndihemi sa më rehat.

Momente të bukura shumë, i kujtoj me shoqërinë nga vende të ndryshme të botës, kulturat që ata kishin dhe mënyra e jetesës na bënte ne të ndryshëm, por ajo çfarë na bashkonte ishte dëshira e madhe për të mësuar nga njëri - tjetri.



Qyteti ishte i madh dhe kishte një arkitekturë shumë të zhvilluar.

Ajo çfarë na pëlqente të bënim ishte të shikonim cdo vend që ishte një atraksion për turistat. Na pëlqente të provonim kuzhina të ndryshme si ato indiane kineze etj.

Kjo eksperiencë nuk të formon vetëm ne aspektin profesional por edhe në ate të menaxhimit të gjërave vet në jetë, të jesh një njeri i pavarur dhe të kalosh cdo vështirësi vet.

Mendoj se për të qenë një student Erasmusi duhet të kesh guxim në veten tënde se ti mund t'ja dalesh.

Nuk duhet t'ju mposhti frika dhe pasiguria por dëshira dhe besimi.

Nëse ti mendon se ajo çfarë ke bërë është gjithcka që duhet, s'ke provuar ende shkëmbimin Erasmus+.

*"Nëse ti mendon
se ajo çfarë ke bërë
është gjithcka që
duhet, s'ke provuar
ende shkëmbimin
Erasmus+."*





Studenti: Haxhire ÇUÇAJ
Institucioni dërgues: Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Programi E+: Shkëmbim Studentor
Institucioni Pritës: Kolegji i Kujdesit Shëndetësor Tallinn, Estoni
Periudha: Qershor - Gusht 2019

“Erasmus+, ia vlen çdo sekondë e këtij programi”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Unë quhem Haxhire Çuçaj, këtë vit mbarova studimet Bachelor në degën Infermieri e Përgjithshme. Që në gjimnaz kam dëgjuar mbi programin e shkëmbimit studentor Erasmus dhe dëshira ka qenë e madhe për të marrë pjesë që atëherë. Në vit të dytë në universitetin tonë u organizua një takim me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, e cila trajtoi në mënyrë shumë të detajuar procesin e këtij programi. Duke dëgjuar dhe eksperiencat e studentëve të tjerë dhe të atyre në të njëjtën degë si unë, më shtuan akoma më tepër dëshirën për të qenë pjesë e këtij programi. Në çdo moment stafi i zyrës ka qenë i gatshëm për të më dhënë informacionet e nevojshme mbi procedurat që duheshin ndjekur, por edhe më jepnin mbështetjen e tyre. Kam aplikuar në program në dhjetor të 2018 dhe në janar 2019 u shpalla fituese.

Duke qenë se unë do të kryeja praktikën profesionale në Estoni, vendosa që të përfundoja vitin shkollor dhe të ndiqja programin në Verë. Zgjedhja më e mirë që kam bërë. Një pjesë pak e vështirë ka qenë përgatitja e dokumentacionit, por Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë më ka ndihmuar në çdo moment, duke përfshirë që dokumentet e duhur për aplikim, ato që kërkonte institucioni pritës por edhe me Learning Agreement. Megjithatë çdo gjë u përfundua me sukses.

Që në momentin e parë kam qenë optimiste, e lumtur dhe e gatshme për këtë eksperiencë të re. Gjithsesi, frika qëndronte sesi unë do të përshtatesha me këtë situatë dhe qytet të ri. Ditët kaluan pa kuptuar dhe momenti që të filloja aventurën time të re kishte ardhur.

Përvojat e mia në Tallinn

Menjëherë sa zbrita nga avioni, po përjetoja një ndjesi se gjithçka do të shkonte mirë dhe do të kaloja bukur. Qyteti ishte fantastik nëse do më thonin të shkoja sërisht atje do të shkoja me shumë dëshirë. Ajo çfarë më bëri përshtypje ishte konvikti, ne kishim fatin e mirë që të gjenim vend në konvikt dhe kushtet ishin fantastike sidomos dhoma jonë, kishim çdo gjë që na nevojitej.

Dalloheshim shumë lehtë nga vendasit atje por pikërisht kjo e bënte më të vecantë sepse nxirrnin gjithmonë e më në pah natyrën e tyre mjaft mikëpritëse. Sidomos stafi mjekësor në spital, ishte mjaft i gatshëm për të na dhënë njohuritë e duhura, për të na mësuar procedurat e nevojshme që duhet të kryejë një infermier gjatë punës. Edhe pse ishim të huaja, ashtu si pacientët e moshuar, por edhe ata të rinj kishin respekt dhe besim tek ne për të ushtruar praktikën tonë.

Sigurisht që pjesë e përvojës së këtij shkëmbimi nuk është vetëm shkolla, por edhe koha e lirë. Momente shumë të bukura që kujtoj është kur mblidheshim si shoqëri për të folur mbi tema të ndryshme, mësonim kulturat e njëri-tjetrit, ndanim eksperiencat tona. Jo vetëm njihnim njëri-tjetrin, por njihnim edhe veten tonë më mirë, sepse je i pavarur dhe duhet të menaxhosh kohën në mënyrë më efikase.

Qyteti kishte një ndërthyryje si të të vjetrës dhe asaj të re-së. Qyteti i vjetër i Tallinn i vendosur në qendër kishte



një stil shumë të veçantë prandaj si turistët, vendasit, por edhe ne shkonim shpesh atje. Ajo çfarë më pëlqente ishte se qyteti organizonte shpesh aktivitete të ndryshme për të gjitha shijet dhe preferencat e njerëzve. U njohëm me traditën e tyre, me ushqimin vendas, pijet e tyre, por duke qenë se jetonim në kryeqytet provuam dhe ushqime të kuzhinave ndryshme si ai indian, meksikan dhe kinez.

Kjo eksperiencë më formoi shumë, jo vetëm në aspektin profesional ku tashmë si infermiere mund të bëj procedura të ndryshme infermierore, si: plotësimi i kartelës infermierore, asistimi në ndërhyrje infermierore, gjetja e venës, ndërrimi i canjula intravenoze, përgatitja e medikamenteve, bandazhimi i plagëve etj. U formova gjithashtu dhe si individ më i mirë, e gatshme për ti bërë ballë problemeve të ndryshme.

Asgjë nuk është e vështirë nëse e dëshiron me të vërtetë diçka. Të gjithë njerëzit kanë frikë, por nëse do të krijosh momente të bukura atëherë duhet të guxosh. Duhet guxuar për të kuptuar a i dëshiron vërtetë ëndrrat e tua, a je ambicioz, dhe po ashtu gjen përgjigje për shumë pyetje të tjera. Dhe nuk ka më mirë se të dalësh nga zona e komfortit falë programit Erasmus, sepse viresh përballë situatave të ndryshme krejt i vetëm. Do flisja pafund rreth të mirave që sjell ky program, por më mirë aplikoni, fitoni dhe do i kuptoni vetë të gjitha këto nga eksperiencia që do kaloni.

Pasiguria dhe mendimet që nuk mund t'ja dilni janë vetëm një hap pas. Mos lejoni t'ju mundin. Aplikoni, kini besim tek vetja dhe mos u dorëzoni. Ja vlen çdo sekond e këtij program!

Ajo çfarë i ndalon njerëzit që të bëjnë atë që duan është frika, prandaj ndalni mendimet dhe bëni atë çfarë ju doni.

*"Krijo
kujtime të
bukura
falë
Erasmus+ "*





Studenti: Henri Arizaj
Institucioni dërgues: Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Programi E+: Shkëmbim Studentor
Institucioni Pritës: Universiteti Teknik Riga, Letoni
Periudha: Janar - Qershor 2020

“Erasmus+, përvoja ime e veçantë dhe e vlefshme”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Unë quhem Henri Arizaj, dhe aktualisht po përfundoj studimet për vitin e II në ciklin e studimeve Bachelor në degën Inxhinieri Elektrike. Programi Erasmus ka qënë një rekomandim nga disa prej pedagogëve të fakultetit tim duke ma prezantuar atë si një mundësi e mirë që u jepet studentëve më të mirë të universitetit tonë.

Gjatë një takimi me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, e cila trajtoi në mënyrë shumë të detajuar procesin e këtij programi, kuptova se ky program ishte një projekt europian i mbështetur dhe financuar nga Bashkimi European. Pas këtij takimi më lindi një dëshirë e madhe për t'u bërë pjesë e këtij programi.

Kështu, si një i ri i etur për dije dhe eksperiencë, ju drejtova Zyres së Marrëdhënieve me Jashtë, e pozicionuar në godinën e Rektoratit, pranë universitetit tim. Aty u ndjeva mirë për shkak të ngrohtësisë që më falën stafi i zyrës, si student i universitetit dhe kandidat i ardhshëm i programit ERASMUS. Ajo çfarë më habiti me se shumti ishte fakti që kishte student pa fund të cilët prisnin në rradhë për t'u rregjistruar në programin e shumëkërkuar ERASMUS. Falë informacioneve paraprake që na dhanë në lidhje me bursat që ky mobilitet ofronte, kuptova që kjo ishte një mundësi e cila vinte vetëm një herë në jetë për studentet. Ky ishte “sinjali” që mos të hezitova më; por të aplikoja sa më parë për të qënë pjesë e këtij programi.

Jo shume larg ditës prej të cilës unë aplikova, një e-mail u shfaq papritmas në ekranin e telefonit tim e cila njoftonte se unë isha një prej fituesve të këtij modaliteti në universitetin RTU. Mendova se gjithcka mbaroi ketu; derisa më nisën një email të dytë në të cilin më informuan lidhur me intervistën që duhet të kryeja për tu pranuar si student shkëmbimi në këtë universitet.

Emocionet që përshkruan trupin tim, ditën e intervistës, ishin po aq të mëdha sa dhe iniciativa që mora. Dy ditë pas intervistës, u shpalla i vetmi student përfitues i një burse për semestrin e dytë në një universitet të madh dhe prestigjioz, si ai i Letonisë, Riga. Gjithcka që më mbetej të bëja që prej atij momenti ishte të prisja biletën e avionit dhe të prisja ditën në të cilën niste udhëtimi im.

Përvojat e mia në Riga

Avioni u nis, duke lënë pas vendlindjen time si dhe pasiguritë e mia. Udhëtimi im sapo filloi. Arritëm në Riga rreth orës 12 të darkës.

Qyteti ishte magjepsës por m'u desh pak kohë për t'u ambientuar me rrugët, temperaturat e acarta, atmosferën e qytetit si dhe banesën në të cilën do kaloja 5 muaj. Mund të them që fillimi në Riga nuk ishte dhe aq sfidues, pasi pranë meje ishin dhe 2 studentë të cilët i njihja mjaft mirë pasi ndanim të njëjtin fakultet, si dhe në atë qytet do takonim dhe shqiptarë të tjerë si pjesëmarrës të këtij programi.

Një prej sfidave më të mëdhaja të këtij rrugëtimi ishte zhvillimi i lëndëve të cilat, përveç përmbajtjes voluminoze,





zhvilloheshin në një gjuhë të huaj dhe në universitet me një staf petagogjik ndryshe nga ai që isha mësuar. Një lehtësi e madhe ishte mikëpritja e ngrohtë dhe gadishmëria që treguan pedagogët dhe studentët aty për të na sqaruar të gjitha paqartësitë që kishim.

Ndoshta kjo experiencë do të ishte më e bukur nëse "COVID-19" -a nuk do të ishte pjesë e jetëve tona, por gjithsesi kam shijuar në maksimum secilin moment aty. Prania e shqiptarëve të tjerë vec nesh në konvikt; fshihi frikën dhe mërzinë që mbulonte fytyrën tonë dhe mbushi mendjet tona me kujtime të paharrueshme, të cilat u gdhendën aty. Pavarësisht se universiteti u mbyll për shkak të situatës, nuk u mbyll dera lidhëse mes nesh dhe leksioneve, të cilat u detyruam t'i ndjekim online nëpërmjet platformave të njohura që dhe studentët shqiptarë ishin duke zhvilluar atë kohë.

Nëse dikush do më pyeste nëse qyteti i Rigës me pëlqeu sadopak, do i përgjigjesha pa hezitim "po". Qyteti i Rigës ishte një qytet i vjetër dhe këtë e dëshmonte arkitektura e tij e vecantë me elemente të teknologjisë së re, kryesisht në qendrën e qytetit. Këto ndërtesa ishin një paradoks; pasi kur hyje brenda tyre ndihesh si "Liza në Botën e Cudirave"; pasi pamja e brendshme kishte një ndryshim ekstrem me atë jashtë.

Përsa i përket ushqimit karakteristik të atij vendi, njihej ndryshe me epitelin "kuzhina e ftohtë" por në atë qytet gjigand gjeje një miks kuzhinash si ajo pakistaneze, indiane, ruse, etj. Ndërsa kultura e tyre ishte e ngjashme me tonën. Më duhet të theksoj se tek këto të fundit u ambientova si unë dhe shqiptarët e tjerë; sa që nuk dalloheshim nga vendasit aty dhe kjo gjë na bëri të ndiheshim si në atdheun tonë.

Gjithashtu udhëtimet ishin aktiviteti ynë i preferuar. Vendet historike dhe arkeologjike të Rigës ishin të shumta por ne nuk mundem t'i shkëlqim dot të gjitha për shkak të pandemisë.

Por, pavarësisht gjithçkaje që ndava më lart, kjo experiencë ishte e vecantë dhe e vlefshme. Eksperienca akademike dhe personale ishte e njëjta ashtu si ajo për të cilën më kishin folur studentët e mëparshëm të cilët ishin bërë pjesë e këtij mobiliteti.

Riga, më bëri të ndihem i vogël para tij por, më mësoi se çfarë ndjesie është të jetosh me pavarësi të plotë vetjake dhe financiare.

Për studentët e rinj të cilët i druhen kësaj aventure kaq fantastike, do t'i rekomandoja të guxonin; të mos ngurronin dhe ta provonin pasi cdo sekondë e saj ia vlen për ta përjetuar të gjithë këtë experiencë të vyer do thosha. Mendoj se, në fund përvec se mëson tradita, kultura; njihesh me njerëz të rinj; zbulon me shumë për veten tënde; zbulon se si ti përshtatesh në ambiente të ndryshme në rrethana të ndryshme dhe mendoj se njeriut pikërisht kjo i nevojitet në fund të fundit; të sfidojë vetveten .

*"Guxo dhe
sfidoje veten;
pasi njeriu është
nxënësi gjatë
gjithë jetës"*





Studenti: Tana Dapaj
Institucioni dërgues: Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Programi E+: Shkëmbim Studentor
Institucioni Pritës: Universiteti Teknik Riga, Letoni
Periudha: Janar – Qershor 2020

“Jam një njeri më i mirë, falë Erasmus+”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Unë quhem Tana Dapaj, viti i dytë master shkencor në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë. Kam dëgjuar për bursën Erasmus + në vitë të parë bachelor nga dy miket e mia. Ato më treguan për eksperiencën e tyre dhe ishin vërtet të kënaqura, mua që atëhere m'u duk shumë interesante, por nuk aplikova menjëherë pasi më dukej akoma shpejtë që të ikja larg familjes time duke qenë se jam shumë e lidhur me ata.

Pas 3 vitesh në një orë mësimi pedagogia që po bëja mësim njoftoi studentet për thirrjen që ishte për degën e shkencave kompjuterike në universitetin e Rigës. Sapo e dëgjova këtë thirrje mendova që kishte ardhur koha e duhur që unë të aplikoj. Në cdo moment stafi i zyrës ka qenë i gatshëm për të më dhënë informacionet e nevojshme mbi procedurat që duheshin ndjekur, por edhe më jepnin mbështetjen e tyre. Kam aplikuar në program në nëntor të 2020 dhe në dhjetor 2020 u shpalla fituese.

Një pjesë pak e vështirë ka qenë përgatitja e dokumentacionit, por Zyra e Marrdhenieve me Jashtë me ka ndihmuar në cdo moment, duke përfshirë që dokumentet e duhur për aplikim, ato që kërkonte institucioni pritës por edhe me Learning Agreement. Megjithatë cdo gjë u përfundua me sukses.

Që në momentin e parë kam qenë e lumtur dhe e gatshme për këtë eksperiencë të re. Gjithsesi frika qëndronte sesi unë do të përshtatesha me këtë situatë dhe qytet të ri. Ditët kaluan pa kuptuar dhe moment që të filloja aventurën time të re kishte ardhur.

Përvoja ime në Riga

Menjëherë sa zbrita nga avioni, po përjetoja një ndjesi të bukur edhe pak e friksuar sesi do orjentoheja në qytet edhe si do ishte "jeta ime e re".

Riga ishte një vend që më ka lënë përshtypje shumë të mirë, ka shumë kujtime në shumë rrugë të saj. Vendi që shkova të jetoja ishte një konvikt privat por me shumë kushte edhe një ambient shumë komode.

Njerëzit në Riga në pamje të parë dukeshin të ftohtë por nëse u këkoje ndihmë ata ishin vërtet miqësorë edhe të sjellshëm. Dalloheshim shumë nga vendasit pasi tiparet i kishin më të zbehta edhe mbizoteronin bjondet, gjithashtu ishin popull shumë i gjatë. Përvoja në shkollë ishte shumë e mirë edhe pse zgjati shumë pak për shkak të pandemisë botërore Covid-19, ku në mars mësimi u ndërpre edhe vazhdoi online. Por me aq pak kohë sa munda të ndjekë mësimin në shkollë pedagogët ishin shumë mbështetës dhe praktikë, pasi më shumë bëhej në laboratore dhe unë nëpërmjet tyre kuptoja në praktikë mësimet që merrja.





Mësova shumë gjëra të reja sic është krijimi i një website për kompani të ndryshme biznesi, si të përmirësoj shërbimin, mësova për agjentët inteligjentë dhe robotikën.

Sigurisht që pjesë e përvojës së këtij shkëmbimi nuk është vetëm shkolla por edhe koha e lirë. Momente shumë të bukura kam kaluar me shumë nga miqtë që njoha si shqiptarë, dhe miq nga gjithë bota. Momente të paharrueshme, udhëtime në shtete të tjera që vërtet kur i mendoj kam qenë e bekuar që i përjetova. Ishim vërtet me fat pasi munda t'i bëja këto gjëra edhe pak udhetime para se pandemia të përhapej.

Qyteti kishte një ndërthurje si të të vjetrës dhe asaj të resë. Qyteti i vjetër i Rigës kishte një stil shumë të vacant prandaj, si turistët, vendasit, por edhe ne shkonim shpesh atje. Aty mund të gjeje dyqanet, restorantet, baret dhe diskotekat me të njohura në Riga. U njohëm me traditën e tyre, me ushqimin vendas, pijet e tyre, por duke qenë se jetonim në kryeqytet provova dhe ushqimet të kuzhinave të ndryshme si ai Indian, pakistanez, francez dhe shumë të tjera.

Kjo eksperiencë më formoi shumë, jo vetëm në aspektin profesional por edhe unë si person. Mësova t'ia dalë vetëm në një vend të huaj, kuptova realisht se sa e aftë isha tja dilja vetem në cdo lloji situatë sepse në Vlorë isha mësuar të kisha gjithnjë pranë familjen. Atje kuptova dhe mësova me shumë kush është Tana e vërtetë dhe sa e aftë jam të përshtatem në ambiente të reja me njerëz të rinjë. Asgjë nuk është e vështirë nëse e dëshiron me të vërtetë dicka. Nëse do të krijosh moment të bukura, atëherë duhet të guxosh.

Ju rekomandoj të aplikoni pasi do kuptoni veten tuaj dhe çfarë doni vërtet. Do ketë dhe moment si shumë të mira dhe jo shumë të mira që do ju aftësojnë më shumë dhe do u rrisin vetbesimin, mposhtni frikën për të njohur veten tuaj.

Gjithashtu do njihni shumë njerëz të rinjë me kultura shumë të ndryshme nga ne dhe shumë interesante. Kjo është një mundësi që ju jepet pse mos ta shfrytëzoni. Mendimet tuaja do ndryshojnë, nuk do gjykoni, do dini të pranoni, do kuptoni që jeni rritur.

*"Bëhuni ju autori i historisë tuaj, mos u përqendroni në një kapitull pasi keni mundësinë të shkruani shumë kapituj të tjerë".
"Ndrysho jetën dhe hap mendjen me Erasmus +"*





Studenti: Tomorr Hoxha
Institucioni dërgues: Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Programi E+: Shkëmbim Studentor
Institucioni Pritës: Università di Studi di Salerno
Periudha: Mars - Korrik 2019

“Erasmus+, trampolina ime drejt punësimit”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Unë quhem Tomorr Hoxha, aktualisht në përfundim të Masterit të Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare, pranë departamentit të Drejtësisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë dhe fal Erasmus+, jurist në profesion. Që në gjimnaz kam dëgjuar për shkëmbimet studentore dhe dëshira për të qënë pjesë e një programi të tillë ka qënë gjithmon një ëndërr. Në vitin e trete në universitetin tonë u organizua një takim me Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë, e cila trajtoi në mënyrë shumë të detajuar procesin e këtij programi.

Duke dëgjuar, rëndësinë e madhe që ky proces kishte por dhe mundësitë që të ofronte dëshira sa vinte dhe po rriten. Në vitin e parë në master në muajin nëntor dhe dhjetor në faqen zyrtare të Universitetit u shpallën thirrjet për shkëmbimet studentore me universitet të ndryshme nëpër Europë. Kjo është mundësia ime thashë me vete.

Mbështetja e prindërve por edhe e profesorëve të mi për të përballur me sfida të reja ma shtuan akoma më tepër dëshirën për të qënë pjesë e këtij programi.

Fillimet ku do të aplikojmë më ngjallin një ndjesi të çuditshme që herë ishte gëzim, emocion dhe në disa momente frikë dhe ankthe. Pasi fillova procesin e përgatitjes së dokumentacionit stafi i zyrës së marrëdhënieve me jashtë ka qënë i gatshëm për të më dhënë informacionet e nevojshme mbi procedurat që duheshin ndjekur, por edhe më jepnin mbështetjen e tyre. Kam aplikuar në program në dhjetor të 2018 dhe në janar 2019 u shpalla fitues. Duke qënë se unë isha në përfundim të vitit të parë master më ngeleshin akoma dhe pak lëndë për të përfunduar studimet e mia dhe kështu vendosa me veten për një sfidë të re, ku zgjodha të bëja pjesë të Learning Agreement. gjithsej 6 provime. Zgjedhja më e mirë që kam bërë, pasi mendoj se sfidat janë një mundësi e mirë për të provuar veten.

Dhe siç e parashikova, çdo gjë përfundoi me sukses.

Që në momentin e parë kam qënë optimist, i lumtur dhe i gatshëm për këtë eksperiencë të re. Gjithsesi frika qëndronte sesi unë do të përshtatesha me këtë situatë dhe qytetin e ri. Ditët kaluan pa kuptuar dhe momenti që të filloja aventurën time të re kishte ardhur.

Përvojat e mia në Salerno

Së bashku me kolegët e tjerë u nisëm nga Vlora me traget dhe menjëherë përjetova një ndjesi se gjithçka do të shkonte mirë dhe do të kaloja në mënyrën më të mirë të mundshme. Mbas 8 orësh udhëtim mbërritem në Salerno.

Qyteti ishte fantastik nëse do më thonin të shkoja sërisht atje do të shkoja me shumë dëshirë. Ajo çfarë më





bëri përshtypje ishte një ndërthurje fantastike e ndërtimeve modern me ato klasike që i jepte qytetit një pamje të mrekullueshme dhe unë kisha fatin e mirë që të gjendesha në një vend të tillë.

Mbas ndjesisë fantastike që të jepte qyteti, gjëra po fillonin të ecnin në rrugën e tyre, ajo ndjesia që pata në fillim të udhëtimit u bë realitet, ku menjëherë na u ofrua ndihmë nga disa qytetarë.

Na ndihmuan me gjetjen e vëndit tonë të qëndrimit, një Hostel i quajtur Grande Have Plena. Një vend fantastik, i mbushur me studentë nga të gjitha vendet e botës.

Sigurisht që pjesë e përvojës së këtij shkëmbimi nuk është vetëm shkolla, por edhe koha e lirë. Momente shumë të bukura që kujtoj është kur mblidheshim si shoqëri për të folur mbi tema të ndryshme, mësonim kulturat e njëri-tjetrit, ndanim eksperiencat tona. Jo vetëm njihnim njëri-tjetrin, por njihnim edhe veten tonë më mirë, sepse je i pavarur dhe duhet të menaxhosh kohën në mënyrë më efikase.

Sigurisht që pjesë e rëndësishme e këtij programi është dhe mikpritja dhe xhentilesa që kishin profesore dhe zyra Erasmus + në Universitetin Pites. Ata ishin thjesht fantastik, të gatshëm për të ndihmuar në çdo rrethanë dhe kohë. Sot jam jurist kjo dhe falë tyre, pasi më mësuam elemente thelbësore të punës dhe profesionit.

Kjo eksperiencë më formoi shumë, jo vetëm në aspektin profesional ku tashmë si jurist mund të bëj procedura të ndryshme. U formova gjithashtu dhe si individ më i mirë, i gatshëm për të bërë ballë problemeve të ndryshme.

Asgjë nuk është e vështirë nëse e dëshiron me të vërtetë diçka. Të gjithë njerëzit kanë frikë, por nëse do të krijosh momente të bukura atëherë duhet të guxosh. Duhet guxuar për të kuptuar. Nëse i dëshiron vërtetë ëndërrat e tua, nëse je ambicioz, Erasmus + është vendi dhe mundësi e duhur. Dhe nuk ka më mirë se të dalësh nga zona e komfortit falë programit Erasmus, sepse vësh përballë situatave të ndryshme krejt të vetëm.

Erasmus mundësi e jete, ju ftoj të aplikoni, sepse ndonjëherë fjalët janë të tepërta. Provojeni dhe në përfundim ju ftoj të mbledhemi së bashku për të diskutuar “Për çdo gjë do më jepni të drejtë”.

Pasiguria dhe mendimet që nuk mund t’ja dilni janë vetëm një hap pas. Mos lejoni t’ju mudi. Aplikoni, kini besim tek vetja dhe mos u dorëzoni. Ia vlen çdo sekondë i këtij programi! Ajo çfarë i ndalon njerëzit që të bëjnë atë që duan është frika, prandaj ndalini mendimet dhe bëni atë që doni. “Krijë kujtime të bukura falë Erasmus+”



Studentë hyrës



Robert Deatcu

Universiteti "Aurel Vlaicu" Arad, Rumani

Të isha student Erasmus në Vlorë ishte MBRESËLËNËSE!

Para se të vija në UV si student Erasmus+ kërkoja faqen e internetit të UV-së, dhe aty gjeta gjithçka që më duhej në një strukturë të ndërtuar shumë mirë. Pas kësaj, gjeta Udhëzuesin e studentëve hyrës të Erasmus+ të UV-së. Më besoni, ky udhëzues është ndoshta udhëzuesi më i mirë që kam parë ndonjëherë për studentët Erasmus+ nga shumë universitete. Aty tregohet saktësisht cdo gjë që duhet të dini në detaje për Shqipërinë, për Vlorën dhe Universitetin, gjë që do ta bëjë integrimin tuaj shumë më të lehtë sepse do t'ju përgjigjet shumë pyetjeve që ju mund të keni. Në zyrën e IRO takova një ekip të ri dhe profesional i cili ishte shumë i përkushtuar për të më ndihmuar të gjeja një strehim, të kontaktoja me profesorët dhe të gjitha gjërat që më duheshin si student Erasmus+. Për shkak të COVID19, kurset e mia ishin online, por edhe në atë situatë, pasi rastet e koronavirusit u pakësuan, fillova të shijoja qytetin e bukur të Vlorës, diellin dhe plazhin e Vlorës! Profesorët janë shumë miqësorë dhe modernë, nëse keni pyetje ata janë të gatshëm t'ju përgjigjen, ata janë thjesht njerëz të shkëlqyer! Nëse më duhet të zgjedh midis mobilitetit tim të mëparshme Erasmus+ në Greqi dhe atij në Shqipëri, do të zgjidhja 100% Universitetin e Vlorës, për atë popull të mrekullueshëm, qytet dhe mot të mrekullueshëm!



Andrea De Simone

Universiteti i Salernos, Itali

Unë jam Andrea, një student juridiku në Salerno. Në vitin 2018 pata mundësinë të shkoj në Erasmus+ në Vlorë (Shqipëri), vend i mrekullueshëm dhe jo vetëm sepse universiteti është pranë detit, por edhe sepse njerëzit këtu janë të mrekullueshëm dhe me diellorë. Mësuesit ishin të sjellshëm dhe më ndihmuar të gjeja qetësi duke më ndihmuar të gjeja akomodim dhe duke më treguar vendet më të bukura për t'u vizituar.

“Krijo kujtime të bukura, falë Erasmus+”



Massimiliano Aliberti

Universiteti i Salernos, Itali

Fjala më e mirë për të përshkruar përvojën time Erasmus në Vlorë është mikpritja. Qyteti dhe njerëzit më falën qetësi që ditën e parë që mbërrita, duke u treguar shumë mirësorë dhe alegri. Profesorët shpjegojnë me plot pasion për studentët e tyre, përfshirë dhe ne studentët Erasmus+. Studentët e tjerë të huaj dhe unë jemi trajtuar si familje nga i gjithë grupi i universitetit, dhe ata na mbështetën dhe na ndihmuan për çdo lloj problemi.

Qyteti është mahnitës dhe stina e verës është momenti më i mirë për të jetuar esencën e vërtetë të Vlorës, por edhe pjesët e tjera të Shqipërisë më befasuan shumë. Erasmus+ në Shqipëri na bëri të ndiheshim sikur nuk dilnim kurrë nga shtëpia, gjetëm miq dhe lumturi, dhe studimi në një vend tjetër na rriti njohuritë më shumë sesa prisnim. Unë sugjeroj që ta jetoni këtë përvojë në Shqipëri për kë ka mundësi, do të jetë një nga kujtimet më të mira të jetës.



Josef Alaa Eddin

Universiteti i Salernos, Itali

**Erasmus+ dhe Shqipëria:
një kombinim kaq i bukur!**

Një përvojë intriguese që ju formëson dhe ju ndihmon të qëndroni me mendje të hapur.

Erasmus+ është një shans për të takuar realitete të reja, për të zbuluar dhe përmirësuar veten. Vlora ishte pikërisht ky, një qytet i madh dhe vazhdimisht në zhvillim! Duke u përfshirë plotësisht në këtë eksperiencë, nga më qesharakja e të folurit të gjuhës lokale në atë më të thjeshtë të shoqërimit me studentët e institucionit pritës, më ka intriguar dhe motivuar menjëherë në studime dhe për të lënë të ashtuquajturën zonën time të rehatisë. Histori e shkurtër: Merrni më të mirën nga jeta, shfrytëzoni rastin dhe bashkohuni me Programin!

| Staf dalës |



Roksana Helena NOWAK
Zyra e Kerkimit Shkencor dhe Publikimeve
Programi Shkëmbim Stafi Administrativ
Institucioni Pritës: Universiteti Jan Kochanowski Kielce
Periudha: 6-12 Maj, 2019

“Jam një njeri më i mirë,
falë Erasmus+”

Rrugëtimi im drejt Erasmus+

Quhem Roksana Helena Nowak. Kam shtetësi të dyfishtë polako-shqiptare.

